



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:023633

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06354780

P.nr.88/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarja e vetëm gjykues Blerta Kelmendi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi-Muçaj, në çështjen penale kundër të pandehurit L.U nga, për shkak të veprës penale “*Vjedhje pyllit*“ nga neni 349 par.3, pika 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1763/2023 të datës 31.01.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik me datë 23.09.2024, në praninë e prokurorit të shtetit Ermal Demhasaj, të pandehuri L.U, mbrojtëses së tij av. Sabrije Abazi, nga Peja, e caktuar sipas detyrës zyrtare, me datë 25.09.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.10.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

L.U, i biri i M., e nënës H. e gjinisë, i lindur me në fsh. K., me vendbanim në, rr. “.....”, nr....., ka te kryer shkollën e, me profesion, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së ekonomike, posedon nr. telefonit, i identifikuar sipas nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Me datë 10.09.2023, rreth orës 23:40, në fshatin Milishevc-Rugovë, në Parkun Kombëtar “Bjeshkët Nemuna” i cili administrohet nga zyra në Pejë, me qëllim të vjedhjes prenë një sasi të masës drusore në vëllim prej 0.70 m³ të llojit ahu, ku fillimisht i prenë e më pas i ngarkon në veturën e tipit ngjyrë e me targa e më pas nisjet për në shtëpi ku gjatë rrugës i harxhohet karburanti dhe veturën e parkon tek vendi i quajtur “Te Sharra”, e cila më pas vërehet

nga patrulla policore ku pas identifikimit të pronarit e njëjta i konfiskohet bashkë me masën drusore,

-Me çka ka kryer veprën penale “*Vjedhja e pyllit*” nga neni 349 par. 3 pika 3.1 të KPRK-së.

Andaj, në aplikim të dispozitave të nenit 7, 38, 39,40,42, 43,46, 47,48,49, 69, 70, neni 349 par.3 nënpar.3.1, lidhur me par.1, të KPRK-së, si dhe nenin 277 par.1, 344, 369, 449, 462, të pandehurin:

E G J Y K O N

- I. **ME DËNIM ME GJOBË**, në shumën prej katërqind (400) euro, të cilin dënim më gjobë, i pandehuri është i obliguar t’a paguaj në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Si dhe **ME DËNIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim ndaj të pandehurit nuk do të ekzekutohet nëse brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti nuk kryen vepër tjetër penale.
- III. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën të cekur si më lartë brenda afatit të lartcekur, gjykata do ta zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ku njëzetë (20) euro gjobë, llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse i pandehuri e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.
- IV. Nëse i pandehuri, brenda periudhës së verifikimit të cekur si më lartë, kryen vepër tjetër penale, dënimi i kushtëzuar si në pikën II të këtij dispozitivi do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- V. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

- VI.** Konform nenit 277 par.1 të KPPRK-së, KONFISKOHET masa drusore e llojit masës drusore e llojit “Ahu”, në vëllim prej 0.70 m³ pa damkë pyjore, e sekuestruar nga i pandehuri, në bazë të Urdhrit Ndalues Përfundimtar UGJK.nr.133/23, e datës 07.11.2023, të cilat ndodhen në administrimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, me çrast e njëjta URDHËROHET që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, masën drusore të cekur si më lartë ta shesë dhe mjetet të kalohen në buxhetin e shtetit.
- VII.** Pala e dëmtuar- përfaqësuesi nga-zyra në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 1763/23, të datës 31.01.2023, kundër të pandehurit L.U, nga fshati, i komunës së, për shkak të veprës penale “*Vjedhje pyllit*“ nga neni 349 par.3, pika 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 23.09.2024, në praninë e prokurorit të shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit L.U, mbrojtëses së tij av.Sabrije Abazi, nga Peja, e caktuar sipas detyrës zyrtare, dhe në mungesë të përfaqësuesit të dëmtuarës sipas autorizuar zyra në Pejë, të cilët kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt, mirëpo mungesën nuk e kanë arsyetuar.

Konform dispozitave të nenit 241 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij, dhe se për mbrojtëse pranon av.Sabrije Abazi, nga Peja, e cila i është caktuar sipas detyrës zyrtare.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, gjyqtarja e vetme gjykuese pasi që është i bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia që të deklarohet në lidhje me pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar paraprakisht për rëndësinë e pranimin të fajësisë dhe pasojat e mospranimin.

I pandehuri L.U, deklaroi që e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ndihet i penduar dhe se i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra tjera penale, duke shtuar se pranimin e fajësisë e bënë vullnetarisht pa asnjë presion.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit e cila ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*. Po ashtu edhe mbrojtësja e të pandehurit av.Sabrije Abazi, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë i njëjti është bërë në konsultim me mua si mbrojtëse dhe i propozoj gjykatës që i njëjti të aprovohet*.

Gjyqtarja e vetëm gjykuese, është bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 dhe par. 6 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: *Raporti i Policit XH.M me nr. të rastit 2023-DA-1528 i dt. 13.09.2023; Raporti i Oficerit I.J PK 5340 i dt. 11.09.2023; Raporti i Oficerit M.B #11411 i dt. 12.09.2023; Deklarata e të pandehurit L.U e dhënë në St. Policor në Pejë me dt 13.09.2023 dhe në PTH- Pejë me datë 26.01.2024; Procesverbal mbi konfiskimin e sortimenteve pyjore e datës 13.09.2023; Foto-dokumentacioni i shkresave të lëndës*, andaj gjykata konform nenit 242 par. 6 mori aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit, konform nenin 356 par.1 i KPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me fjalën përfundimtare dhe shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit, ka deklaruar se: *ne kuptim të rrethanave rënduese i propozoj gjykatës që të merr parasysh ndonjë dënim eventual të mëparshëm ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë*.

Mbrojtësja e të pandehurit av.Sabrije Abazi, ka deklaruar se: *meqenëse i mbrojturi im e pranoj fajësinë në këtë fazë po ashtu e ka pranuar edhe para prokurorit i njëjti ka bashkëpunuar mirë lusim gjykatën që të ketë parasysh dhe të merr si rrethana lehtësuese po ashtu edhe faktin se vëllimi i veprës është i vogël domethënë nuk është asnjë metër kub dru te cilat i mbrojturi ri im i ka pasur për nevoja te tij personale, nuk ka pasur qëllime për ti shitur, ta ketë parasysh gjendjen e tij ekonomike te dobët dhe të ketë parasysh bashkëpunimin e tij me gjykate andaj i propozoj gjykatës qe ta merr një vendim me te cilin dënohet me kusht ose me gjobë megjithëse i mbrojturi im gjendjen momentalisht nuk e ka te mirë ekonomike. Po ashtu desha ta njoftoj gjykatën se i*

njëjti tani ka një kontratë ne Gjermani të punës prandaj e lusim gjykatën që ta ketë parasysh edhe ketë fakt në mënyrë që të mos pengohet për të shkuar për të filluar punë atje.

I pandehuri L.U, ka deklaruar se: *jam i penduar për veprën penale të kryer i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale. I njëjti deklaron kjo është hera ime e parë që gjendem në gjykatë, masën e drurëve të cilat i kam marr i kam pasur për shfrytëzim personal, jam mbajtës i vetëm i familjes.*

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit L.U, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Vjedhja e pyllit” nga neni 349 par.3, nën par. 3.1 të KPRK-së.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale e të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të pandehurit ashtu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë së të pandehurit, i njëjti është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata ka konsideruar: pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, e poashtu faktin se i njëjti nuk është i dënuar më parë, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Vendimin mbi dënimin e përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shqiptimin e dënimit me gjobë si dhe dënimin me burgim të kushtëzuar, gjykata e mori në kuptim të nenit 46, 47, 48, dhe 49 par.1 sipas të cilit “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, ndërkaq në par.4 përcaktohet se: “Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale”. Ndërkaq, në përputhje me dënueshmërinë e përcaktuar sipas nenit 349 par.3 të KPRK-së, për veprën penale “Vjedhja e pyllit”, gjykata vlerëson se dënimi me kusht sa i përket dënimin me burg do të arrijë qëllimin e dënimit. Për më tepër gjykata vlerëson se tërheqja e vërejtjes të të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej 1 viti do të kryej vepër

tjetër penale ndaj tij do të ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitivin e këtij aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që i njëjtit të parandalohet në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Sipas bindjes së gjyqtares së vetme gjykuese, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në bazë të nenit 277 par.1 të KPPRK-së, ka vendosur për ta konfiskuar masën drusore të llojit “Ahu”, në vëllimin prej 0.70 m³, të sekuestruara nga i pandehuri L.U, në bazë të Urdhrit Ndalues Përfundimtar UGJK.nr.133/23, e dt.07.11.2023, të cilat ndodhen në administrimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, nga shkakun se është vërtetuar fakti se masa drusore është përfituar me kryerjen e veprës penale ‘Vjedhja e pyllit’ nga neni 349 par.3, nënpar.3.1 të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 277 par.8, të KPPRK-së, gjykata ka urdhëruar Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar që të shesë masë drusore të llojit “Ahu” në sasi prej 0.70 m³, e sekuestruar nga i pandehuri L.U, në bazë të Urdhrit të lartcekur dhe mjetet nga shtija e kësaj mase të kalohen në buxhetin e shtetit.

Duke u bazuar në nenin 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.9 të KPPRK-së dhe nenit 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, e obligoi në pagesën e taksës në shumën prej njëzetë (20) euro, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike është marrë duke u bazuar në nenin 462 të KPPK-së, me çrast pala e dëmtuar (.....) -zyra në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPPRK-së, gjykata e përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.88/24, me datë 25.10.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale:

Gjyqtarja vetme gjykuese:

Leonita Lajqi-Mucaj

Blerta KERMENDI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.